




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo



Komuna e Gjilanit
Opština Gnjilane
Gilan Belediyesi

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT

Në bazë të Ligjit për Zyrtarët Publikë, Nr/L-114 neni 67, Ligjit për Arsimin Parauniversitar, Nr. 04/L-032 neni 35 si dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ (MASH), Nr.151/2020 për Detyrat dhe Përgjegjësitë e Drejtorit dhe të Zv.Drejtorit të Institucionit Publik Edukativo – Arsimor dhe Aftësues Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Procedurat e Zgjedhjes dhe Emërimit, Përfundimit të Kontratës dhe Emërimit të Përkohshëm, Drejtoria Komunale e Arsimit në GjiJan, rishpallë :

RISHPALLJE E KONKURSIT PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË LIRA TË PUNËS

Institucioni: Komuna e Gjilanit
Departamenti/Drejtoria: e Arsimit
Lloji i pozitës: Jo karrierës
Numri i Pozitave: katër (4)
Titulli i mbikëqyrësit: Drejtori i Drejtorisë Komunale të Arsimit
Grada/Koeficienti: Sipas ligjit për pagat në sektorin publik
Orët e punës: 40
Kohëzgjatja e emërimit: katër (4) vite
Titulli i vendeve të punës :

1. Drejtor i Shkollës Fillore të Mesme të Ulët " Ibrahim Uruqi" në fsh. Bresalc
2. Drejtor i Shkollës Fillore të Mesme të Ulët "Dëshmorët e Kombit" në fsh. Livoq i Ulët
3. Drejtor i Shkollës së Mesme të Lartë Gjinnazi Shoqëror " Zenel Hajdini" në GjiJan
4. Drejtor i Shkollës së Mesme të Lartë Ekonomike " Marin Barleti" në GjiJan

Qëllimi i vendit të punës:

Menaxhimi, organizimi dhe mbikëqyrja e procesit arsimor në institucionin edukativo arsimor.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

- Zbatimi i ligjshmërisë në fushën e arsimit;
- Zhvillimin e një plani afatmesëm dhe afatgjatë për aktivitetin e drejtorisë;
- Përgatitjen e planit vjetor, planit zhvillimor të institucionit edukativo-arsimor dhe raportet vjetore të punës
- Aftësimin e personelit në Institucion;
- Planifikimin dhe shfrytëzimin racional të buxhetit;
- Detyrat e caktuara për zgjedhjen, vlerësimin, disiplinën dhe çështjet e tjera që kanë të bëjnë me mësimdhënësit dhe nëpunësit e tjerë të arsimit;
- Përdorimin efikas dhe efektiv të sistemit të informatave për menaxhimin e arsimit dhe respektimin e kodeve të ndërlikuara të praktikës;
- Caktimin e masave disiplinore ndaj nxënësve;
- Planifikimin, udhëheqjen dhe koordinimin të gjitha aktiviteteve në Institucion;
- Si dhe detyrat dhe përgjegjësitë e tjera të parapara në nenin 3 të Udhëzimit Administrativ (MASH) Nr. 151/2020, ligjeve dhe akteve të tjera nënligjore.

Kandidati/ja i/e interesuar duhet t'i plotësoj këto kushte:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës,
- Të kenë të kryer arsimin universitar të nivelit;
- 1. Master për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim (kualifikimi prej 300 ECTS, së paku 5 vite të shkollimit universitar);
- 2. Master arsimor (kualifikimi prej 300 ECTS/ 5 vite të shkollimit universitar);
- 3. Katërvjeçar (kualifikimi prej 240 ECTS/ 4 vite të shkollimit universitar);
- 4. Bachelor katërvjeçar (kualifikimi prej 240 ECTS/ 4 vite të shkollimit universitar);
- Të kenë licencë të rregullt të mësimdhënësit sipas udhëzimit për licencim të mësimdhënësve;
- Të kenë të përfunduar me sukses një program të akredituar të kualifikimit profesional për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim të bazuar në standardet e praktikës profesionale për Drejtor të Shkollave në Kosovë, të aprovuar nga MASH sipas rekomandimit KSHLM;
- Të ketë përvojë pune në procesin edukative – arsimore sipas udhëzimeve të përcaktuara në katalogun e punës:
Pesë (5) vite në procesin edukativo arsimor për kandidatët për drejtor në arsimin e mesëm të lartë,
Katër (4) vite përvojë pune në procesin edukativo-arsimor për kandidatët për drejtor në niveleve tjera:
Tri (3) vite përvojë pune në procesin edukativo-arsimor për kandidatët për zëvendësdrejtor.
Për shkollat profesionale të AAP dhe Qendrat e Kompetencës, kandidati/ja duhet të jetë me përgatitje profesionale të profileve përkatëse të institucionit ku konkurron.

Kandidati/ja duhet të posedoj dhe dëshmoj dokumentet në vijim:

- Diploma e fakultetit - masterit të kryer për nivelin përkatës të kualifikimit ;
- Certifikatën për kryerjen me sukses të programit të trajnimit për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim, të bazuar në standardet e praktikës profesionale për Drejtor të Shkollave në Kosovë; (Kandidati/ja që ka të përfunduar programin universitar Master për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim, në mungesë të certifikatës së trajnimit për udhëheqje në arsim, ofron dëshminë e diplomës Master në këtë fushë të studimeve) ;
- Kopjen e dokumentit të identitetit (ID);
- Certifikatën shëndetësore të lëshuar në gjashtë muajt e fundit nga një institucion shëndetësor i licencuar me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore;
- Dëshminë se nuk është nën hetime dhe dëshminë se nuk ka qenë i/e dënua për krim, dhunë ose vepra të padenja që përfshijnë fëmijët;
- Dëshminë për përvojën e punës në procesin edukativo-arsimor;
- Deklaratën nën betim që vërteton se në tri vitet e fundit kandidati/ja nuk ka qenë në asnjë funksion udhëheqës në strukturat e partive politike;
- Portofolin profesionale me dëshmi sipas udhëzimeve në shtojcën/formularin H të UA – 151/2020;
- Planin zhvillimor të institucionit edukativo arsimore dhe aftësuese për të cilin ka konkurruar (së paku 10 faqe tekst me hapësirë 1.5, fonti i shkronjave 12: Arial) sipas udhëzimeve të MASHT-it;
Sqarim : Kandidati/ja ka të drejt të aplikoj në një ose më shumë shkolla. Në rastet e tilla përgatit dokumentacion të ndarë për secilën shkollë ku aplikon.
Kandidati/ja ka të drejt të ketë qasje në planin zhvillimor aktual të institucionit për të cilin aplikon dhe mënyrën e mbështetjes për të siguruar kopjen e planit zhvillimor.

Konkursi mbetet i hapur për aplikim 15 ditë nga data : 01.06.2023 deri me 15.06.2023.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen.

Të gjithë kandidatët e interesuar, aplikacionet mund ti marrin në formë fizike në Qendrën për Shërbim me Qytetarë, apo ti shkarkojnë nga web faqja zyrtare e Komunës së Gjilanit <https://kk.rks-gov.net/gjilan/> dhe portali shtetëror <https://konkursi.rks-gov.net/> dhe të plotësuara t'i dorëzojnë në Qendrën për Shërbim me Qytetarë në Komunën e Gjilanit.

Dokumentacioni i kandidatëve të cilët nuk i plotësojnë kushtet e konkursit nuk do të shqyrtohet, ndërsa në intervistë do të ftohen vetëm kandidatët nga lista e ngushtë.

Të gjithë kandidatët të cilët kanë mbaruar studimet jashtë Shtetit të Republikës së Kosovës si dhe nëpër kolegjet private brenda Republikës së Kosovës, e që konkurrojnë për këto pozita, duhen që diplomat e tyre (gradat universitare të fituara) të jenë të njohura nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në pajtim me Udhëzimin Administrativ, nr.12/2018 të datës 10.09.2018, në të kundërtën komisioni gjatë selektimit të aplikacioneve, do të refuzoj çdo aplikacion të kandidatëve të cilët nuk e kanë plotësuar këtë kusht të konkursit.

Për kohën dhe vendin e mbajtjes së intervistave, kandidatët do të informohen përmes email, njoftimit i cili do të publikohet në tabelat e objektit të Drejtorisë Komunale të Arsimit dhe ueb faqen e Komunës.

